



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:018776

Datë: 18.11.2020

Numri i dokumentit: 01282218

P.nr.776/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, nëpërmjet gjyqtarit të vetëm gjykues Sabedin Mushica, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Blerina Hyseni, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S. B, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës(KPRK-ës),¹ të cilin me autorizim e mbron avokat Faruk Brestovci, nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.81/2017, të datës 27.07.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 15.10.2020, i shpallur me datë 19.10.2020, i përpiluar me datë 18.11.2020, këtë

AKTGJYKIM

I akuzuari S. B, nga babai B., nëna H., e lindur A., i lindur më datën ..., Komuna e Gjilanit, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të kryer katër vite të shkollës fillore, i papunë, e gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 09.12.2016, rreth orës 14:45-14:55, Komuna e Gjilanit, i akuzuari me veprime të rrezikshme shkaktonte rrezik të madh për jetën e njerëzve, në atë mënyrë që në pusin e mbushur me ujë, i thellë rreth 1.50 centimetra, 3.70 centimetra i gjatë dhe 2 metra i gjërë, që gjendet rreth 100-150 metra larg nga oborri i shtëpisë së të akuzuarit, e i cili pus është hapur diku para 30 viteve, pa rrethojë, i pasiguruar dhe pa tabela paralajmëruese, që përdoret për ujitje të tokës, ashtu që tani i ndjeri, fëmiju 6 vjeçar, A.Z, nipi i të akuzuarit bie në të dhe humb jetën.

-me këtë ka kryer veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 77 dhe 78 të KPRK, si dhe nenit 326 dhe nenit 365, të Kodit të Procedurës Penale(KPP-ës),² i akuzuari i lartckeur:

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20 prill 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

LIROHET NGA DËNIMI

Ngase pasoja e veprës penale të shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe 2 të KPRK-ës, nga dispozitivi i këtij aktgjykimi, e ka goditur aq rëndë të akuzuarin, sa që dënimi është i panevojshëm për realizmin e qëllimit të tij.

Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25,00 € (njëzet e pesë) euro si dhe shumë prej 30€(tridhjetë)euro, për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 5 ditëve, pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 31.07.2017, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit S. B, për shkak të veprës penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe 2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor, në të cilin shqyrtim kanë prezantuar prokurorja e shtetit Huma Jetishi, të dëmtuarit G. Z dhe V. Z³, i akuzuari S. B me mbrojtësin e tij avokat Faruk Brestovci, ku pas leximit të aktakuzës i akuzuari i lartcekur ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale të lartcekur.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe provat materiale të rastit konkret, të cilat janë paraqitur së bashku me aktakuzë dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP-ës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari S. B, e ka kryer veprën penale të lartcekur, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata ka vendosur që të akuzuarin S. B , ta shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase në

³ Sicili veç e veç kanë deklaruar se nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe se nuk paraqesin kërkesë pasurore juridike, njëkohësisht e kanë njoftuar gjykatën se të akuzuarin e ka baba të gruas dhe se të njejtin rasti i ndodhur e ka prekur shumë, po ashtu edhe në aspektin shpirtëror.

veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është penalisht përgjegjës.

5.Vendimi për lirim nga dënimi.

Në nenin 78 paragrafi 1 të KPRK-së parashihet se “gjkata mundë ta lirojë nga dënimi kryesin e veprës penale të kryer nga pakujdesia në rastet e mëposhtme:

1.1. nëse pasojat e asaj vepre penale e godasin kryesin aq rëndë sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij; ose

1.2. nëse kryesi menjëherë pas kryerjes së veprës penale ka bërë përpjekje për evitimin ose zvogëlimin e pasojave të asaj vepre dhe nëse në tërësi apo në një masë të madhe e ka kompensuar dëmin e shkaktuar me atë vepër

Gjkata, pas shikimit me kujdesë të të gjitha shkresave të lëndës si dhe pas dëgjimit të prokurores së shtetit, të dëmtuarve, mbrojtësit të të akuzuarit dhe vetë të akuzuarin, gjatë fjalës përfundimtare të palëve, ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale i akuzuari S. B duhet të lirohet nga dënimi sa i përket veprës penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi ngase janë plotësuar kushtet ligjore që parashihen në dispozitën e lartcekur ligjore. Në njëërën anë vepra penale është kryer nga pakujdesia, ku i akuzuari tani të ndjerin A.Z. e ka patur nip, rrespektivisht djalë të vajzës, kurse në anën tjetër pasojat e kësaj vepre penale e kanë goditur aq rëndë të akuzuarin, ku në mes tjerash ka deklaruar se “nëse kishte ekzistuar ndonjë mundësi që nipin tim tani të ndjerë ta kthejë në jetë, unë kisha vdekur në vedn të tij, ashtu që sot e kësaj dite më mundon shumë ky rast” dhe gjykata konsideton se dënimi do të ishte i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

6.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuari, gjykata, duke u bazuar nenin 451 paragrafi 1 të KPP ka obliguar që akuzuarin të paguajë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30€ si dhe shumën prej 30€ për viktimat e krimit, në afat prej 15 ditëve, pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyruar.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

P.nr.776/2017

Më 18 nëntor 2020

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Sabedin Mushica

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.